



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 126/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Altec” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-47080-01-06-2020, me objekt: “*Loti II, Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me fond limit 4.353.159 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 30.01.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Altec” sh.p.k..
Adresa: Rruga “E Durrësit”, pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, P240/1, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 07.01.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-47080-01-06-2020, me objekt: “Loti II, Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, me fond limit 4.353.159 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 30.01.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 30.01.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 13.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Superior Klima” sh.p.k.	2.955.920 lekë	skualifikuar
2. “Altec” sh.p.k.	3.051.687 lekë	skualifikuar
3. “Nika” sh.p.k.	3.500.050 lekë	skualifikuar
4. “Climacasa sh.p.k. & AL-TEK sh.p.k.	3.700.455 lekë	skualifikuar
5. “Sulollari-klima sh.p.k. & 2Z Konstruksion sh.p.k.	3.790.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 13.02.2020 operatori ekonomik “Altec” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e saj në këtë procedurë prokurimi me pretendimin si më poshtë:

- *Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ në pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër.*”.

II.5. Në datën 20.02.2020 operatori ekonomik “Altec” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë:

[...] Të nderuar Kryetar, anëtarë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave!

Operatori ynë ekonomik ka dorëzuar ofertë në procedurën e prokurimit me objekt “Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni””, me fond limit: 4,353,159 (katër milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Më datë 13.02.2020 u njohëm me firmat që kanë marrë pjesë dhe renditjen e tyre si më poshtë:

<i>Superior Klima Klima</i>	<i>2.955.920 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Altec</i>	<i>3.053.106 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Nika</i>	<i>3.500.050 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Climacasa</i>	<i>3.700.455 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Sulollari Klima</i>	<i>3.790.000 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>

Po më datë 13.02.2020 u njohëm me njoftimin e vlerësimit ku të gjithë firmat pjesëmarrëse përfshire dhe firmën tonë janë skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Referuar vlerësimit të KVO ju informojmë paraprakisht se vendimi i KVO në lidhje me skualifikimin e shoqërisë toëne është totalisht në shkelje me aktet ligjore, si dhe nënligjore, duke shkaktuar shkelje të barazisë në tendera.

Nisur nga ky konstatim i yni po ju parashtrojme pretendimin tonë lidhur me njoftimin e skualifikimit si më poshtë vijon:

Ne, operatori ekonomik “ALTEC” sh.p.k. jemi skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara me arsyen: “Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ në pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër”. Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti teknik pika 3.3.3 është parashikuar konkretisht si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1 (një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- diplomë
- kontrata pune të vlefshme
- librezë pune

Bazuar në kriterin e sa më sipër cituar në nënpikën 3 të pikës 3.3 të kapaciteteve teknike të dokumentave standarte të tenderit ne si operator ekonomik "ALTEC" sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sa më sipërcituar kemi ngarkuar në SPE në mënyrë rigoroze dokumentat teknike përkatësisht, skedarët përkatës të inxhinierit elektrik z. A. H me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil, i cili është drejtues teknik pranë shoqërisë tonë, dhe do të jetë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në objekt i kësaj procedure prokurimi, i cilësuar kjo edhe nëpërmjete deklaratës së paraqitur nga ana jonë.

Për punonjësën me profesione si më sipër, janë paraqitur dokumentat e kërkuara në nënpikën 3 të pikës 3.3, përkatësisht:

- Diplomë
- Kontratë pune
- Librezë pune
- Deklaratën e administratorit të shoqërisë i cili cakton si person përgjegjës për lotin II pikërisht inxhinierit elektrik z. A. H.
- Si dhe licensa ku vërtetohet eksperiencia e tij shumëvjeçare.
- Listpagesat e shoqërisë.

Përsa më sipër gjykojmë se pretendimet e autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin tonë nuk qëndrojnë dhe është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit, ne si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinier elektrik/inxhinier mekanik me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

Pra, i nderuar z. Kryetar i autoritetit kontraktor vendimi i KVO- së, për skualifikimin e ofertës tonë duket qartësisht se është i nxituar, i gabuar, dhe në shkelje të plote me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, rrjellimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj.

Kujtojmë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës se:

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të, prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53, pika 3, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

Në nenin.66, pika.3, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

I nderuar Z. Kryetar, në përfundim, jemi të bindur në pretendimet tona të bazuara në Ligj dhe në prova, në baze të LPP, VKM dhe DST, ndaj dhe kërkojmë nga ana juaj Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e shoqërisë tonë “Altec” sh.p.k. duke e kualifikuar atë.

Përsa më sipër kërkojmë:

1. Pezullimin e procedurës së prokurimit.
2. Kualifikimin e ofertës së shoqërisë Altec sh.p.k..
3. Mbetjen të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik Superior Klima Klima.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 24.02.2020 me shkresën nr.300/2 prot, operatori ekonomik ankimues “Altec” sh.p.k. është vënë në dijeni në lidhje me pranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me arsyetimin si më poshtë:

Pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara është depozituar ankesa protokolluar me tonën me nr.300 prot, datë 20.02.2020 nga ofertuesi “Altec” sh.p.k. për vlerësimin e ofertës së paraqitur në procedurën e prokurimit ‘Procedurë e Hapur – Shërbime’ – Marrveshje Kuadër me afat 24- muaj, me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt “Riparim, Mirëmbajtjeje Sistemit të Ngrohje-Ftohjeve”, ndarë në 3 (tre) lote konkretisht për Lotin II “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, me fond të marrëveshjes kuadër 4.353.159 lekë (pa-TVSH), me nr. REF-47080-01-06-2020, me datë të mbylljes së vlerësimit 13.02.2020. Ankesa është paraqitur brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni mbi vlerësimin e ofertës. Me marrjen e ankesës me shkrim, organi qendror blerës pezulloi vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar sipas parashikimeve të nenit 63 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2, 3, 5: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankesuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”, si dhe të VKM nr/914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 5:

“Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme punësnga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit.”, pasi u shqyrtuan të gjitha dokumentat e vëna në dispozicion për këtë procedurë prokurimi, ju komunikojmë vendimin si më poshtë:

1. Ofertuesi “Altec” sh.p.k. ka ankimuar skualifikimin e për mospërmbushjen të kriterit të përcaktuar në Shtojcën nr.8 në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” seksioni 3.3 “Kapaciteti teknik” pika 3, në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: ‘3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- diplomë*
- kontrata pune të vlefshme*
- librezë pune.”.*

***Me pretendimin si vijon: [...]** “...Bazuar në kriterin e sa më sipër cituar në nënpikën 3 të pikës 3.3 të kapaciteteve teknike të dokumentave standarte të tenderit ne si operator ekonomik “ALTEC” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sa më sipërcituar kemi ngarkuar në SPE në mënyrë rigoroze dokumentat teknike përkatësisht, skedarët përkatës të inxhinierit elektrik z. A. H me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil, i cili është drejtues teknik pranë shoqërisë tonë, dhe do të jetë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në objekt i kësaj procedure prokurimi, i cilësuar kjo edhe nëpërmjete deklaratës së paraqitur nga ana jonë. Për punonjësin me profesione si më sipër, janë paraqitur dokumentat e kërkuara në nënpikën 3 të pikës 3.3, përkatësisht:*

- Diplomë*
- Kontratë pune*
- Librezë pune*
- Deklaratën e administratorit të shoqërisë i cili cakton si person përgjegjës për lotin II pikërisht inxhinierit elektrik z. A. H.*
- Si dhe licenca ku vërtetohet eksperiencia e tij shumëvjeçare.*
- Listpagesat e shoqërisë.*

Përsa më sipër gjykojmë se pretendimet e autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin tonë nuk qëndrojnë dhe është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit, ne si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinier elektrik/inxhinier mekanik me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

Pra, i nderuar z. Kryetar i autoritetit kontraktor vendimi i KVO- së, për skualifikimin e ofertës tonë duket qartësisht se është i nxituar, i gabuar, dhe në shkelje të plote me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, rrjellimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj.

Kujtojmë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës se:

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të, prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Në nenin.66, pika.3, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

I nderuar Z. Kryetar, në përfundim, jemi të bindur në pretendimet tona të bazuara ne Ligj dhe në prova, në baze të LPP, VKM dhe DST, ndaj dhe kërkojmë nga ana juaj Shfuqizimin e vendimit të KVO- së për skualifikimin e shoqërisë tonë “Altec” sh.p.k. duke e kualifikuar atë.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentat e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi “Altec” sh.p.k., pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së tij, konstaton si më poshtë”

Për ofertuesin “Altec” sh.p.k., Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht dhe dhënë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 13.02.2020, arsyet e skualifikimit të tij si vijon: “Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marveshje kuadër”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga ofertuesi “Altec” sh.p.k. e konstatoi: Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shtojcën 8 në “Kriteret e Veçanta të kualifikimit” seksioni 3.3 “Kapaciteti teknik”, pika 3 në dokumentat e tenderit, ofertuesi “Altec” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin “Deklaratë për drejtuesin teknik”.

Në këtë dokumentacion z. Arben Aliaj në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Altec” sh.p.k. ka deklaruar se në tenderin Loti II “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, drejtues teknik i shoqërisë do të jetë z. A.H.

Në dokumentacionin me emërtimin “Ing_elektrik_Agim_Hasani”, pjesë janë dhe libreza e punës, kontrata dhe diploma, licenca, CV për personin e sipërcituar.

Në shtojcën 8 në dokumentat e tenderit është bërë shënimi se: Operoret ekonomike që do të ofertojnë për më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 3.2 nënpika 1) e kriterëve të veçanta për kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 3.3 e kriterëve të veçanta për kualifikim,) sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra së bashku”, nga verifikimi rezulton se ofertuesi “Altec” sh.p.k. ka ofertuar në dy lote për këtë procedurë prokurimi, konkretisht Loti I me objekt: “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Loti II “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.

Në shtojcën nr.8 në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” seksioni 3.3 “Kapaciteti teknik” pika 4, në dokumentat e tenderit për Lotin I përcaktohet:

“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.”.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimin “Deklaratat për drejtuesin teknik”.

Në këtë dokumentacion z. Arben Aliaj në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Altec” sh.p.k. ka deklaruar se në tenderin Loti I “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, drejtues teknik i shoqërisë do të jetë z. E.M. Në dokumentacionin me emërtimin “Ing_Mekanik_Ektrik_Manushi”, pjesë janë dhe libreza e punës, kontrata dhe diploma, CV për z. E.M.

Dokumentacioni i dorëzuar nga ofertuesi “Altec” sh.p.k. për dy lotet në të cilat ky ofertues ka ofertuar më konkretisht për Lotin I me objekt:

“Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Loti II me objekt: “Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni” e plotëson kriterin komulativ për punonjësin e kërkuar në pikën 3 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” shtojca 8 në dokumentat e tenderit në Lotin II dhe punonjësit e kërkuar në pikën 4 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” shtojca 8.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Altec” sh.p.k. pranohet.

II.7. Në datën 02.03.2020, pala ankimuese “Altec” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë:

I nderuar Kryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit Prokurimit Publik!

Shoqëria “Altec” sh.p.k. bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik nr.9643, datë 20.11.2006 të ndryshuar, Neni 63 dhe VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Neni 78 Ju paraqet për shqyrtim ankesën prezente.

Në datën 30.01.2019 autoriteti kontraktor “Agjencia e Blerjeve të Përqendruara” zhvilloi procedurën e hapur të Prokurimit me objekt: “Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni””, me fond limit: 4,353,159 (katër milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Më datë 13.02.2020 u njohëm me firmat që kanë marrë pjesë dhe renditjen e tyre si më poshtë:

<i>Superior Klima Klima</i>	<i>2.955.920 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Altec</i>	<i>3.053.106 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Nika</i>	<i>3.500.050 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Climacasa</i>	<i>3.700.455 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>Sulollari Klima</i>	<i>3.790.000 lekë</i>	<i>skualifikuar</i>

Po më datë 13.02.2020 u njohëm me arsyen e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga ana jonë me pretendimin si më poshtë:

“Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës ëper kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marveshje kuadër”.

Më datë 19.02.2020, paraqitëm ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit, si dhe duke kërkuar kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë.

Më datë 24.02.2020, u njohëm me përgjigjen e autoritetit kontraktor me nr.300/2 prot, datë 24.02.2020 dërguar me shkresën përcjellëse nr.300/3 prot, datë 24.02.2020, ku autoriteti kontraktor na njofton se ka paranuar ankesën tonë, pro në gjë e tille nuk është pasqyruar në SPE.

Përsa më sipër, duke qënë se faktikisht ankesa jonë nuk është pranuar nga ana e AK, pasi nuk është pasqyruar në SPE, po ju parashtrojmë ankesën si më poshtë:

Në datën 30.01.2019 autoriteti kontraktor “Agjencia e Blerjeve të Përqendruara” zhvilloi procedurën e hapur të prokurimit me objekt: “Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni””, me fond limit: 4,353,159 (katër milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH,, ku operatori ekonomik shoqëria “Altec” sh.p.k. u paraqit si ofertues, duke ofertuar për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve me çmimin e ofertës në vlerën prej 3.053.106 lekë. Pas shqyrtimit të vlerësimit të ofertave autoriteti

kontraktor vendosi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik shoqëria “Altec” sh.p.k., duke pretenduar si shkak për skualifikimin e shoqërisë sa më poshtë:

Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marveshje kuadër.

Operatori ynë ekonomik “Altec” sh.p.k., duke ju referuar veprimeve arbitrare të autoritetit kontraktor, i cili na skualifikoi në mënyrë të pa drejtë nga procedura në fjalë objekt ankimi, paraqitëm ankesë pranë autoritetit kontraktor, ankesë e cila është pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, por duke mos kryer rivlerësim të procedurës. Në vazhdim brenda afatit ligjor po paraqesim ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke qënë se skualifikimi jonë i bërë nga autoriteti kontraktor është i padrejtë dhe i pabazuar në prova dhe ligj, si dhe i qëllimsht autoriteti kontraktor nuk po zbaton vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, i cili ka pranuar ankesën tonë por çuditëisht AK nuk kryen rivlerësimin e procedurës në sistem duke na kualifikuar, ndodhur në këto kushte po ju paraqesim për shqyrtim ankesën tonë.

Operatori ynë ekonomik ka dorëzuar ofertë në procedurën e prokurimit me objekt “Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni””, me fond limit: **4,353,159** (katër milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Më datë 13.02.2020 u njohëm me firmat që kanë marrë pjesë dhe renditjen e tyre si më poshtë:

Superior Klima Klima	2.955.920	lekëskualifikuar
Altec	3.053.106	lekëskualifikuar
Nika	3.500.050	lekëskualifikuar
Climacasa	3.700.455	lekëskualifikuar
Sulollari Klima	3.790.000	lekëskualifikuar

Po më datë 13.02.2020 u njohëm me njoftimin e vlerësimit ku të gjithë firmat pjesëmarrëse përfshire dhe firmën tonë janë skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Referuar vlerësimit të KVO ju informojmë paraprakisht se vendimi i KVO në lidhje me skualifikimin e shoqërisë toëne është totalisht në shkelje me aktet ligjore, si dhe nënligjore, duke shkaktuar shkelje të barazisë në tendera.

Nisur nga ky konstatim i yni po ju parashtrojme pretendimin tonë lidhur me njoftimin e skualifikimit si më poshtë vijon:

Ne, operatori ekonomik “ALTEC” sh.p.k. jemi skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara me arsyen: “Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marveshje kuadër”. Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se nga ana e

autoritetit kontraktor në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti teknik pika 3.3.3 është parashikuar konkretisht si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- diplomë
- kontrata pune të vlefshme
- librezë pune

Bazuar në kriterin e sa më sipër cituar në nënpikën 3 të pikës 3.3 të kapaciteteve teknike të dokumentave standarte të tenderit ne si operator ekonomik "ALTEC" sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sa më sipërcituar kemi ngarkuar në SPE në mënyrë rigoroze dokumentat teknike përkatësisht, skedarët përkatës të inxhinierit elektrik z. A. H me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil, i cili është drejtues teknik pranë shoqërisë tonë, dhe do të jetë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në objekt i kësaj procedure prokurimi, i cilësuar kjo edhe nëpërmjete deklaratës së paraqitur nga ana jonë.

Për punonjësin me profesione si më sipër, janë paraqitur dokumentat e kërkuara në nënpikën 3 të pikës 3.3, përkatësisht:

- Diplomë
- Kontratë pune
- Librezë pune
- Deklaratën e administratorit të shoqërisë i cili cakton si person përgjegjës për lotin II pikërisht inxhinierit elektrik z. A. H.
- Si dhe licensa ku vërtetohet eksperiencia e tij shumëvjeçare.
- Listpagesat e shoqërisë.

Përsa më sipër gjykojmë se pretendimet e autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin tonë nuk qëndrojnë dhe është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit, ne si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinier elektrik/inxhinier mekanik me eksperiencë pune jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

Pra, për sa më sipër vendimi i KVO- së, për skualifikimin e ofertës tonë duket qartësisht se është i nxituar, i gabuar, dhe në shkelje të plote me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, rrjellimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të, prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53, pika 3, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Në nenin.66, pika.3, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

I nderuar Z. Kryetar, të nderuar anëtar të KPP, në përfundim, jemi të bindur në pretendimet tona të bazuara në Ligj dhe në prova, në baze të LPP, VKM dhe DST, ndaj dhe kërkojmë nga ana juaj Shfuqizimin e vendimit të KVO- së për skualifikimin e shoqërisë tonë “Altec” sh.p.k. duke e kualifikuar atë, detyrimin e autoritetit kontraktor që të zbatojë vendimin e KSHA-së, dhe të kryejë rivlerësimin e procedurës, duke na kualifikuar si operator ekonomik fitues.

Përsa më sipër kërkojmë:

- 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit.*
- 2. Kualifikimin e ofertës së shoqërisë Altec sh.p.k..*
- 3. Detyrimin e Autoritetit Kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke e kualifikuar operatorin tone ekonomik “Altec” sh.p.k..*

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.486/1 prot, datë 17.03.2020, protokolluar me tonën me nr. 266/2 prot, datë 17.03.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Altec” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të ndalet në arsyetimin, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Vlen të sqarohet se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesit, në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve të tij, pa i hyrë në thelb shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit, për faktin se procedurat e ndjekura nga autoriteti kontraktor në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nuk ishin shumë të qarta vetëm nga dokumentacioni i paraqitur prej ankimuesit në Komisionin e Prokurimit Publik.

Në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, pas shqyrtimit, verifikimit e ballafaqimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton si më poshtë:

III.1.1. Në datën 13.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës në procedurën e prokurimit, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Superior Klima” sh.p.k.	2.955.920 lekë	skualifikuar
2. “Altec” sh.p.k.	3.051.687 lekë	skualifikuar
3. “Nika” sh.p.k.	3.500.050 lekë	skualifikuar
4. “Climacasa sh.p.k. & AL-TEK sh.p.k.	3.700.455 lekë	skualifikuar
5. “Sulollari-klima sh.p.k. & 2Z Konstruksion sh.p.k.	3.790.000 lekë	skualifikuar

Operatori ekonomik “Altec” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi: *“Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ në pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër.”*

III.1.2. Në përgjigje të ankesës të operatorit ekonomik “Altec” sh.p.k, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 86/10 prot., datë 20.02.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor, pas shqyrtimit të ankesës, arsyetoi se pretendimi i shoqërisë ankimuese për skualifikimin e tij qëndron, ndaj dhe vendosi pranimin e ankesës së shoqërisë “Altec” sh.p.k.

III.1.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.

III.1.4. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se; *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në*

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Në nenin 55 pika 4 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...]Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit [...]”

Në nenin 66, pika 3, të Vendimit nr.914, të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”.

Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla.”.

III.1.5. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”.

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është

ekspert i fushës, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari

të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.”.

Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...] *Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës i komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit.*

III.1.6 Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative).

Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë.

Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave).

Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në

kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

III.1.7. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar në S.P.E procesin e rivlerësimit të ofertave, në zbatim të vendimeve të titullarit të autoritetit kontraktor në rast të pranimit/mos pranimit të ankesave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës/subjekte të

interesuara në procedurë prokurimi, sic parashikohet në nenin 12 dhe 55 pika 4 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të pasqyrojnë në SPE vlerësimin për të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit, në përputhje me nenin 55 pika 4 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si më sipër cituar, në mënyrë që këta të fundit të kenë mundësi të paraqesin pretendimet e tyre dhe të rivendosin të drejtat e tyre nëpërmjet procesit të ankimimit, sikundër parashikohet në pikën 2, neni 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe në pikën 5, të nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor për parregullsitë e konstatuara si më sipër, dhe në rast përsëritjeje, do të propozohen masa administrative për personat përgjegjës, në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Altec” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-47080-01-06-2020, me objekt: “Loti II, Riparim, mirëmbajtjeje e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Spitalin Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, me fond limit 4.353.159 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 30.01.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe të respektojë afatet e ankimimit në zbatim të nenit 63 të LPP-së.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Altec” sh.p.k..

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 266 Protokolli; Datë 02.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha